




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE



V E N D I M

Nr. 24, datë 20.1.2016

P Ë R

KRIJIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË KONKURRUESHMËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, shkronjat "a", "b", "c", "d" dhe "e", e 7, të ligjit nr.8957, datë 17.10.2002, "Për ndërmarrjet e vogla e të mesme", të ndryshuar, të neneve 5, 7 e 8, të ligjit nr.10303, datë 15.7.2010, "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)", dhe të ligjit nr.147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë, me vlerë të përgjithshme 84 000 000 (tetëdhjetë e katër milionë) lekë, për periudhën 2016-2018. Vlera e fondit për secilin vit do të jetë 28 000 000 (njëzet e tetë milionë) lekë.
2. Fondi Shqiptar i Konkurrueshmërisë u jep ndihmë financiare të drejtpërdrejtë ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme deri në 70% të kostove të pranueshme, por jo më shumë se 1 400 000 (një milion e katërqind mijë) lekë.

Në kostot e pranueshme që mund të bashkëfinancohen përfshihen kostot për:

- a) përmirësim produkti, përfshirë ambalazhimin dhe etiketimin, certifikim produkti, vlerësim konformiteti dhe zbatim të sistemeve të menaxhimit të cilësisë;
- b) pjesëmarrje në panairë jashtë vendit;
- c) krijim faqeje interneti, zhvillim të tregtisë elektronike dhe promovim, publikim dhe hartim materialesh promovuese.

3. Përfitojnë nga Fondi Shqiptar i Konkurrueshmërisë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) Prodhonë në Shqipëri produkte dhe/apo ofrojnë shërbime, të cilat tregtohen brenda dhe/apo jashtë vendit;
  - b) Kanë selinë e tyre brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
  - c) Kanë një strategji dhe plan marketingu;
  - ç) Janë në gjendje të financojnë 100 për qind të gjitha kostot e projektit, të propozuara para përfundimit të tij;
  - d) Kanë paguar të gjitha detyrimet e parashikuara nga legjislacioni tatimor dhe doganor.
4. Pagesa e subvencionit bëhet 50%, me miratimin e projektit, dhe 50%, në fund të zbatimit të tij. Pagesa në fund të projektit do të bëhet kundrejt faturave të shpenzimeve të kryera për vlerën e përgjithshme të projektit.
  5. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) për menaxhimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë.
  6. Procedurat e aplikimit dhe kriteret për përzgjedhjen e përfituesve përcaktohen në rregulloren e funksionimit të Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë, e cila miratohet nga ministri përgjegjës për ekonominë.
  7. Aplikuesit janë të detyruar të raportojnë periodikisht pranë AIDA-s lidhur me zhvillimin e projektit dhe qëllimin për të cilin është përfituar ky fond.
  8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për ekonominë, e cila krijon një zë të veçantë për këtë qëllim, për llogari të AIDA-s.
  9. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

**MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT,  
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES**

**ARBEN AHMETAJ**